



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 440 Prot.

Tiranë, më 28.032019

**VENDIM Nr. 66, datë 18.03.2019**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 3, datë 18.03.2019, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Maligrad" 2019*, drejtuar nga Prof. Dr. Adem Bunguri (IA) në bashkëpunim me Prof. Dr. Stavros Oikonomidis (Instituti i Marrëdhënieve Ndërballkanike-Athinë (Greqi), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Maligrad" 2019*, drejtuar nga Prof. Dr. Adem Bunguri (IA) në bashkëpunim me Prof. Dr. Stavros Oikonomidis (Instituti i Marrëdhënieve Ndërballkanike-Athinë (Greqi), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme, duke bërë pjesë të grupit të punës një specialist të periudhës së Antikitetit të Vonë dhe Mesjetës:
  - Gërmime që do të përqëndrohen në pjesën veriore dhe JP të ishullit, për të verifikuar natyrën e depozitimeve kulturore, në pikat më të përshtatshme për gërmim.
  - Gërmimi dhe dokumentimi i rrënojave të një godinë kulti paleokristiane në platformën e ishullit.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2019.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR  
ELVA MARGARITI  
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Rudina Zoto", is written over the printed name of the Secretary of the Technical Secretariat.